

新编

阿尔巴尼亚语教程

Kurs i Gjuhës Shqipe

第三册 Vëllim III

肖桂芬 编



外语教学与研究出版社

新 编

阿尔巴尼亚语教程

Kurs i Gjuhës Shqipe

第三册 Vëllimi III

肖 桂 芬 编

外语教学与研究出版社
北 京

图书在版编目(CIP)数据

新编阿尔巴尼亚语教程. 第三册 / 肖桂芬编. — 北京: 外语教学与研究出版社, 2005. 12

ISBN 7-5600-5322-X

I. 新… II. 肖… III. 阿尔巴尼亚语—教材 IV. H792

中国版本图书馆 CIP 数据核字 (2005) 第 156302 号

出 版 人: 李朋义

责任编辑: 袁 芬 卢柯陈

封面设计: 牛茜茜

出版发行: 外语教学与研究出版社

社 址: 北京市西三环北路 19 号 (100089)

网 址: <http://www.fltrp.com>

印 刷: 北京外国语大学印刷厂

开 本: 850×1168 1/32

印 张: 11

版 次: 2006 年 1 月第 1 版 2006 年 1 月第 1 次印刷

书 号: ISBN 7-5600-5322-X

定 价: 14.90 元

* * *

如有印刷、装订质量问题出版社负责调换

制售盗版必究 举报查实奖励

版权保护办公室举报电话: (010)88817519

前 言

《新编阿尔巴尼亚语教程》是为北京外国语大学阿尔巴尼亚语专业本科教学而编写的一套教材，共四册，适合基础阶段(一、二年级)教学使用。

本教程力求做到以下三点：

一、内容的实用性和持久性

对句型、课文、例句、练习等精心设计，尽量贴近现实生活和交际需要，以便学以致用。课文在历史、地理、政治、经济、文化艺术、旅游、体育、民俗等方面充分反映对象国的风貌，兼顾中国文化和当今世界的人文科学和自然科学。

二、知识的系统性和专业性

在语法教学上注意分散难点，循序渐进，对重点词语精讲多练，使学生牢固掌握阿尔巴尼亚语的基本技能。练习的设计包括听说读写译各个方面的训练，内容尽可能丰富实用。

三、语言的准确性和规范性

教材中所使用的语言符合现代阿尔巴尼亚语的规范，书写上以阿尔巴尼亚科学院 1978 年颁布的正字法为依据。

本书供阿尔巴尼亚语专业本科生第三学期使用，共 16 课，约含 1200 个生词。教材分“课文”、“语言点”和“练习”三部分。“课文”大多选自阿尔巴尼亚原文，编者进行了一定的删改，使之适用于教材。“语言点”包括三个方面：1. “习语和词组”：主要针对课文中出现的习语和常用词组进行扩充，便于学生们掌握。2. “词汇及用法”：词汇选自课文中出现的常用词汇，以动词为主，根据词汇的基本语义和主要用法给出例句。词的各种不同的语义大

多是从词的基本语义引申出来的。理解和掌握了一个词汇的最基本的语义，就会在实践中融会贯通。3. “具体语法项目”：阿尔巴尼亚语的基本语法在一、二册已经大致讲解一遍，但要真正掌握还需要大量的实践。本册主要根据实践运用词法的某些具体语法问题进行补充，在补充的同时进行相关词法的复习，重点在运用。“练习”大部分是围绕课文和相关词汇及语法编写的，兼有动词各种时态的练习。为了使学生学到更多的知识，同时又兼顾到学生以后就业的需要，练习中还增加了部分阅读内容（诗歌和短文），教师可根据情况灵活掌握。

在编写过程中参考了阿尔巴尼亚语相关教材，尤其是各类语法书，吸收借鉴了其中的一些内容。没有一一注明出处，在此谨向有关作者表示感谢。

柯静老师对全书进行了审阅，阿尔巴尼亚专家 Ruzhdi Stringa 对本书的阿语部分进行了审阅，夏镇老师、陈逢华老师也在此书的编写过程中给予了许多帮助，在此深表谢意。

本教材的编写和出版离不开北京外国语大学科研处、外语教学与研究出版社和欧洲语言系的大力支持，在此表示诚挚的谢意。

教材中难免有不妥和疏漏之处，衷心期待使用本教材的教师、同学以及其他读者的批评指正。

编 者
2005 年 5 月

目 录

Mësimi 1	1
§ Tekst	1
A. Liqenet artificiale mbi Drin	1
B. Zhdukja dhe lindja e një qyteti	4
§ Pika gjuhësore	8
I. Shprehje dhe togfjalësja	8
II. Fjalë dhe përdorime	10
III. Theksi dhe intonacioni	12
§ Ushtrime	13
Mësimi 2	21
§ Tekst	21
A. Antarktida	21
B. Amundseni dhe Poli i Jugut	24
§ Pika gjuhësore	27
I. Shprehje dhe togfjalësja	27
II. Fjalë dhe përdorime	29
III. Emri në trajtën e shquar	30
§ Ushtrime	32
Mësimi 3	40
§ Tekst	40
A. Lëviz për shëndetin	40
B. Sporti i atletikës	42
§ Pika gjuhësore	47
I. Shprehje dhe togfjalësja	47

II. Fjalë dhe përdorime	48
III. Shkallët e mbiemrave dhe ndajfoljeve	49
§ Ushtrime	51
Mësimi 4	60
§ Tekst	60
A. Biçikleta	60
B. Biçikleta në botë	64
§ Pika gjuhësore	67
I. Shprehje dhe togfjalësja	67
II. Fjalë dhe përdorime	69
III. Emri në trajtën e pashquar	70
§ Ushtrime	71
Mësimi 5	77
§ Tekst	77
A. Pema e ullirit	77
B. Rënia e gjetheve	81
§ Pika gjuhësore	83
I. Shprehje dhe togfjalësja	83
II. Fjalë dhe përdorime	85
III. Emrat që përdoren vetëm në njëjës	87
§ Ushtrime	88
Mësimi 6	95
§ Tekst	95
A. Celulari, i dëmshëm si duhani	95
B. Telefonja, mania e ballkanasve	98
§ Pika gjuhësore	101
I. Shprehje dhe togfjalësja	101

II. Fjalë dhe përdorime.....	103
III. Emrat që përdoren vetëm në shumës.....	104
§ Ushtrime.....	106
Mësimi 7	115
§ Tekst.....	115
A. Korridori VIII panevropian.....	115
B. Shqipëria dhe Korridori VIII.....	118
§ Pika gjuhësore.....	122
I. Shprehje dhe togfjalësja.....	122
II. Fjalë dhe përdorime.....	123
III. Emrat e dygjinishëm dhe asnjans.....	125
§ Ushtrime.....	127
Mësimi 8	135
§ Tekst.....	135
A. Kinemaja shqiptare (I).....	135
B. Kinemaja shqiptare (II).....	138
§ Pika gjuhësore.....	142
I. Shprehje dhe togfjalësja.....	142
II. Fjalë dhe përdorime.....	144
III. Rasa emërore dhe gjinore e emrave.....	146
§ Ushtrime.....	147
Mësimi 9	155
§ Tekst.....	155
A. Zemra dhe emocionet.....	155
B. Puna e zemrës.....	159
§ Pika gjuhësore.....	162
I. Shprehje dhe togfjalësja.....	162

II. Fjalë dhe përdorime	163
III. Rasa dhanore e emrave	165
§ Ushtrime	167
Mësimi 10	175
§ Tekst	175
A. Zbritja e njeriut në Hënë	175
B. Zbritja në Hënë	178
§ Pika gjuhësore	182
I. Shprehje dhe togfjalësha	182
II. Fjalë dhe përdorime	185
III. Bashkimet e trajtave të shkurtra	187
§ Ushtrime	188
Mësimi 11	199
§ Tekst	199
A. Sami Frashëri	199
B. Abdyl Frashëri	204
§ Pika gjuhësore	209
I. Shprehje dhe togfjalësha	209
II. Fjalë dhe përdorime	210
III. Disa përemra të pacaktuar	212
§ Ushtrime	214
Mësimi 12	224
§ Tekst	224
A. Mbi kujtesën (I)	224
B. Mbi kujtesën (II)	229
§ Pika gjuhësore	232
I. Shprehje dhe togfjalësha	232

II. Fjalë dhe përdorime	235
III. Disa lidhëza kundërshtore	236
§ Ushtrime	238
Mësimi 13	247
§ Tekst	247
A. Tuneli nën La Mansh	247
B. E njëzeteteta, ... e vërteta!	250
§ Pika gjuhësore	254
I. Shprehje dhe togfjalësja	254
II. Fjalë dhe përdorime	256
III. Pjesëzat mohuese: <i>jo, mos, nuk, s', pa</i>	258
§ Ushtrime	260
Mësimi 14	270
§ Tekst	270
A. Shkencë dhe teknikë në Kinë	270
B. Shkenca dhe prodhimi	275
§ Pika gjuhësore	278
I. Shprehje dhe togfjalësja	278
II. Fjalë dhe përdorime	280
III. Parashtesa për-	282
§ Ushtrime	284
Mësimi 15	295
§ Tekst	295
A. Tragjedi nga pakujdesia (I)	295
B. Tragjedi nga pakujdesia (II)	298
§ Pika gjuhësore	301
I. Shprehje dhe togfjalësja	301

II. Fjalë dhe përdorime	302
III. Parashtesat <i>mos-</i> , <i>pa-</i> dhe <i>jo-</i>	304
§ Ushtrime	307
Mësimi 16	316
§ Tekst	316
A. Një qyp me florinj	316
B. Kupa magjike.....	321
§ Pika gjuhësore	326
I. Shprehje dhe togfjalësja	326
II. Fjalë dhe përdorime	328
III. Disa parashtesa të huaja	330
§ Ushtrime	332

Mësimi 1

Tekst

A. Liqenet artificiale mbi Drin

Drini, lumi më i madh në rrjetin e përgjithshëm hidrografik të Shqipërisë, si dhe një ndër lumenjtë kryesorë e piktoreskë të bregut lindor të detit Mesdhe, është një lumë tipik malor me gjatësi 285 km, si dhe me një rënie prej 685 m, që i përgjigjet një pjerrësie mesatare prej 2,3%. Ai grumbullon ujërat e një pellgu me një sipërfaqe të përgjithshme prej 14 173 km². Prurja mesatare shumëvjeçare e Drinit në derdhje është 352 m³/s. Mirëpo, rrjedhja ujore në këtë lumë, si pasojë e ndikimit të klimës tipike mesdhetare, nuk është konstante, por ndryshon me kufij shumë të gjerë, përkatësisht nga 80 m³/s në periudhën e verës deri në 6500 m³/s në atë të dimrit. Së bashku me rrjedhën e tij ujore, Drini transporton gjithashtu edhe sasi të mëdha lënde të ngurtë, të gërryera në pellgun e tij ujëmbledhës si pasojë e procesit të erozionit. Në këto kushte të veçanta natyrore, Drini më parë ka qenë një lumë tepër i rrëmbyer dhe krejtësisht i palundrueshëm.

Mbi këtë lumë janë ndërtuar tri hidrocentrale të mëdha, hidrocentrali i Vaut të Dejës, i Komanit, dhe i Fierzës. Me ndërtimin e këtyre hidrocentraleve u bë i mundur jo vetëm shfrytëzimi i potencialit hidroenergjetik natyror të këtij lumi, por u krijua gjithashtu edhe mundësia reale për lundrim nëpër liqenet artificiale të tij. Këto liqene zgjaten njëri pas tjetrit, thuajse përgjatë gjithë rrjedhës së lumit, duke filluar që nga ai i Vaut të Dejës që ndodhet në Ultësirën bregdetare të Adriatikut në afërsi të Shkodrës, e duke u lartësuar kështu shkallë-shkallë, derisa arrihet

në liqenin artificial të Fierzës, i cili është krijuar në rrëzën e faqeve jugore të Alpeve Shqiptare.

Liqeni artificial i Vaut të Dejës u ndërtua në vitin 1971 në rrjedhën e poshtme të Drinit. Ky liqen e ka sipërfaqen e pasqyrës së ujërave $24,7 \text{ km}^2$, thellësinë më të madhe 52 m dhe vëllimin 580 milionë m^3 ujë. Forma e përzgjatur e pasqyrës së ujërave të liqenit të Vaut të Dejës ndjek konturet e luginave në të cilat ai është formuar. Ka gjatësi maksimale 10 km dhe gjerësi 1,2 km. Nëpër këtë liqen të zgjatur, i cili ndodhet i vendosur midis shpateve të pjerrëta malore, që zbresin me një bukuri të rrallë e të veçantë natyrore deri në sipërfaqen e lirë të ujërave, lundrohet me lehtësi dhe me kënaqësi deri në Koman.

Liqeni artificial i Komanit u ndërtua në vitin 1985 pas ndërtimit të digës së hidrocentralit të Fierzës. Ky liqen ka një sipërfaqe prej 12 km^2 dhe një vëllim rreth 450 milionë m^3 ujë. Forma e liqenit ndjek konturet e luginave në të cilat ai është formuar. Ka gjatësi maksimale 35,2 km dhe gjerësi rreth 1 km. Nëpër këtë liqen tashmë lundrohet nga Komani e deri në Fierzë.

Liqeni artificial i Fierzës është krijuar në vitin 1978 në rrjedhën e sipërme të lumit Drin, në Fierzë. Ai zgjatet deri në vendin e bashkimit të Drinit të Bardhë me Drinin e Zi në Kukës. Ky liqen e ka sipërfaqen e pasqyrës së ujërave $72,5 \text{ km}^2$, thellësinë maksimale 128 m, dhe vëllimin 2,7 miliardë m^3 . Ai ndodhet i vendosur në kuotën 167 m mbi nivelin e detit. Forma e përzgjatur e pasqyrës së ujërave të liqenit të Fierzës ndjek konturet e luginave në të cilat ai është formuar. Ka gjatësi maksimale 61 km. Nëpër liqenin artificial të Fierzës lundrohet nga Fierza deri në Kukësin e ri, që është ndërtuar në brigjet lindore të këtij liqeni, në një largësi prej rreth 39 km.

Si rrjedhim, liqenet artificiale mbi lumin Drin, përveç të tjerave, shërbejnë gjithashtu edhe për zhvillimin e transportit të brendshëm ujor. Lundrimi nëpër këto liqene të bukura malore tashmë ka rëndësi ekonomike e turistike.

Fjalë të Reja

artificial, -e mb.	人工的, 人造的, 人为的
rrjet, -i m.sh. -e, -et	网, 网络
i(e) përgjithsh/ëm(me) mb.	总的, 全面的
hidrografik, -e mb.	水文的
piktoresk, -e mb.	风景如画的, 风景优美的
Mesdhe, -u m.	地中海
gjatësi, -a f.sh. -, -të	长, 长度
pjerrësi, -a f.sh. -, -të	坡度, 斜度: 倾斜
pell/g, -gu m.sh. -gje, -gjet	水塘: 流域
prurje, -a f.sh. -e, -et	带来: 水流量
mesatar, -e mb.	平均的, 中间的, 中等的
rrjedhj/e, -a f.sh. -e, -et	流淌: 流量
konstant, -e mb.	固定的, 不变的
përkatësisht ndajf.	相应地, 对应地
sasi, -a f.sh. -, -të	数量, 数目
lëndë, -a f.sh. -ë, -ët	原料: 木材; 对象: 学科
i(e) ngurtë mb.	坚硬的, 生硬的; 固体的
i(e) gërryer mb.	被冲刷的, 被侵蚀的
erozion, -i m.sh. -e, -et	风化: 水土流失
i(e) rrëmbyer mb.	急速的; 被劫的
i(e) palundruesh/ëm(me) mb.	不通航的, 不可航行的

potencial, -i *m.sh.* -e, -et

real, -e *mb.*

lundrim, -j *m.sh.* -e, -et

ultësirë, -a *f.sh.* -a, -at

lartësohem *fol.*

shkallë-shkallë *ndajf.*

pasqyrë, -a *f.sh.* -a, -at

thellësi, -a *f.sh.* -, -të

vëllim, -i *m.sh.* -e, -et

i(e) përzgjatur *mb.*

kontur, -i *m.sh.* -e, -et

maksimal, -e *mb.*

i(e) pjerrët *mb.*

kuotë, -a *f.sh.* -a, -at

digë, -a *f.sh.* -a, -at

rrjedhim, -i *m.sh.* -e, -et

potencial, shprehje: forca

real, faktual, i mundur

lundrim, udhëtim

lartësi

ndodhet, ndodhet, ndodhet

ndodhet

ndodhet: ndodhet

ndodhet: ndodhet; ndodhet

ndodhet: ndodhet; ndodhet

ndodhet

ndodhet, ndodhet

ndodhet: ndodhet

ndodhet, ndodhet

ndodhet: ndodhet

ndodhet, ndodhet

ndodhet, ndodhet

B. Zhdukja dhe lindja e një qyteti

Anija rrëshqet lehtë mbi liqen dhe jemi harruar duke vështuar pamjet përreth. Befas timonieri i anijes na kujton se tani po lundrojmë mbi qytetin e vjetër. Ne ulim sytë poshtë duke u përpjekur se mos dallojmë konturet e ndonjë rrënoje, por nuk mund të shohim asgjë, përveç një mase të zezë. të turbullt pa asnjë formë të përcaktuar.

Timonieri zë ç na tregon për qytetin e nënujshëm të mbytur, sikur është duke shëtitur në rrugët e tij. “Ja, këtu jemi mbi shkollën e mesme, këtu jemi mbi pallatin e kulturës... atje tej është hoteli...”. Ai vazhdon të flasë si një ciceron muzeumi. Ne përpiqemi të

marrim me mend ato çka thotë ai, përpigemi të përfytyrojmë qytetin e mbytur. Dhe vjen e na shtohet një lloj nostalgjie për rrugët e qytetit të vjetër. E ndiejmë këtë dhe në mënyrën se si flet timonieri. Megjithëse janë mbytur godinat, nuk mund të harrohet kaq lehtë historia e një qyteti të tërë, nuk mund të harrohen episodet nga jeta e gjithsecilit që ka jetuar, që ka mësuar e punuar atje poshtë. Pikërisht në ato rrugë kur ne fëmijët e dikurshëm luanim futboll, tani sundon një qetësi e nënujshme, sundon uji.

Megjithatë, timonieri flet për objektet e nënujshme sikur të mos kenë pësuar asgjë... “Po lundrojmë mbi pallatin e kulturës, mbi shkollën tetëvjeçare...”. Dhe vërtetë pikërisht në këto vende e rrugë në fillim të viteve '60 u fol shumë për zhdukjen e ardhshme të qytetit dhe lindjen e një qyteti të ri. Atëherë qyteti i vjetër nuk e besoi asgjësimin e tij. Jo vetëm ne fëmijët, por edhe të rriturit flisnin për mbytjen e qytetit si për një diçka aq të largët sikur nuk bëhej fjalë për qytetin e tyre, por për një tjetër që ndodhej diku tej në horizont, shumë prapa maleve. Kishte hipoteza nga më të ndryshmet rreth zhdukjes dhe lindjes së një qyteti të ri. Banorët e kishin tepër të vështirë të përfytyronin se si për shkak të ngritjes së një hidrocentrali, rreth njëqind kilometra larg qytetit, do të krijohet një liqen i madh dhe me ujërat e tij do të mbyten fshatra të tërë, si edhe qyteti i tyre i dashur. Për këtë vetëm projektuesit e hidrocentralit të ardhshëm të Fierzës ishin të sigurtë.

Ajo që i habiti më pas banorët e atëhershëm të Kukësit ishte vendi ku flitej se do të ngrihej qyteti i ri. Ai vend ishte një pyll i dendur, aq i dendur sa që, kalimtarët e rrallë që kalonin andej, merrnin masa mbrojtëse nga kafshët e egra. Por ajo që ishte vendosur, nisi të bëhej menjëherë realitet. Ndërtuesit nisën punën. U shpyllëzua vendi dhe u la vetëm një pjesë e vogël pylli për të

kujtuar në të ardhmen se si ka qenë dikur ai vend. Pallati i parë, i dyti, i tretë... dhe banorët e parë filluan disi të ndrojtur jetën aty ku më parë kishte vetëm pyje dhe shkurre. Kështu dalëngadalë qyteti i ri po hidhte shtat, por qyteti i vjetër përsëri rezistonte.

Vitet kaluan dhe qyteti i ri kishte marrë konturet, kishte krijuar rrugët e tij, qenë ndërtuar shkolla e parë, institucione të ndryshme social-kulturore, kishin marrë formë trotualet, për të filloi të shkruhet edhe në shtyp. Banorët nisën ta quanin atë, Kukësi i Ri. Kishte nisur kështu bashkëjetesa e dy qyteteve me të njëjtin emër, bashkëjetesë që do të vazhdonte gjer në ditët e mbytyjes së qytetit të vjetër. Ndërsa qyteti i ri zbukurohej me ndërtesa të reja shumëkatëshe, qyteti i vjetër sikur vjetërohej gjithnjë e më tepër nga largimi i njorëzve që vendoseshin atje lart te qyteti i ri. Por kishte jo pak nga banorët që nuk donin të largoheshin deri sa të vinte uji. E kishin të vështirë të ndaheshin me shtëpitë dhe rrugët e vjetra, me të cilat lidheshin mjaft episode e kujtime nga jeta e tyre. Kishte të tjerë që, megjithëse banonin në qytetin e ri, vinin vazhdimisht për të parë qytetin e vjetër. Mirëpo erdhi një kohë kur Kukësi i vjetër u boshatis i tëri. Pritej mbytyja e tij. Tashmë qyteti i ngjante një të sëmuri rëndë. Vetëm në qoshen e një rrugice dukeshin dritat e një kafeneje të vogël. Banorët e qytetit të ri nxitonin të pinin kafen e fundit në Kukësin e vjetër. Një grua e moshuar shkoi, në ato ditë, të pastronte shtëpinë e saj të boshatisur, megjithëse pas pak atë do ta mbulonte uji. Çdo gjë në qytetin e vjetër ndodhte për herë të fundit. Edhe shiu, edhe dëbora, edhe vizita e njorëzve.

Dalëngadalë, uji mbuloi gjithçka. Të fundit që u larguan nga qyteti i vjetër, ishin macet, që, megjithatë, i gjetën të zotët e tyre në qytetin e ri. Ishte viti 1978.